



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2020:138587  
Datë: 26.01.2023  
Numri i dokumentit: 03908355

A.nr.1732/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Luljeta Maxhuni, dhe me bashkëpunëtoren profesionale Edita Kolgeci, në konfliktin administrativ sipas padisë të paditësit, H.A, të cilin e përfaqëson e autorizim E.G, avokat në Prizren, kundër të paditurës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Prishtinë- Agjencia Pyjore e Kosovës, të cilin e përfaqëson e autorizim L.M, për shkak të anulimit të vendimit, në shqyrtimin kryesor publik, në prani të palëve ndërgjyqëse, me datë 23.12.2022 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet kërkesëpadia e paditësit H.A, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi me numër KE-735/2020 i datës 15.09.2020, i të paditurës Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural- Agjencia Pyjore e Kosovës, si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Me datën 23.12.2022 është mbajtur shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridiko-administrative, në kuptim të nenit 42 të ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në prani të palëve ndërgjyqëse, respektivisht palës paditëse, palës së paditur.

Paditësi me padi, parashtruar në gjykatë më: 20.10.2020, kërkon nga gjykata që t'i aprovohet padia dhe kërkesëpadia, dhe të anulohet vendimi i të paditurës MBPZHR, me numër te referencës KE-735/2020, dhe të obligohet MPPZHR- Agjencia Pyjore e Kosovës që paditësit t'ia jap në shfrytëzim paluajtshmerinë e kërkuar sipas dokumentacionit të plotësuar, nëse i plotëson kushtet

ligjore. Padiësi, me tej, në padi ka theksuar se i ka bërë kërkesë MBPZHR, për ti dhënë në shfrytëzim një sipërfaqe prej 5 hektarësh, në njësinë kadastrale 4944 zona kadastrale Zhur, për të cilën paraprakisht ka marrë pëlqim nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinorë të Komunës së Prizrenit, të datës 26.12.2019, me çka pastaj ka marrë edhe një autorizim për nxjerrjen e dokumentacionit të nevojshëm nga Drejtorati Koordinues-Rajonal, me seli në Prizren të datës 19.12.2019, me çka ka nxjerrë certifikatën e pronësisë për parcelën 04944-0 XK Zhur, ka dalë së bashku me gjeometrin e licencuar dhe ka caktuar koordinatat, pikat dhe matjet detale në teren dhe pas plotësimit të të gjitha dokumenteve i'u është dorëzuar kërkesa për dhënien e kësaj paluajtshmërie në shfrytëzim për biznes familjar duke i dhënë edhe arsyetimet e shfrytëzimit të së njëjtës. Andaj për nxjerrjen e dokumenteve, kufizimin dhe vërjen e koordinatave me gjeometrin dhe për daljen në teren të zyrtarëve për verifikim janë krijuar shpenzime të konsideruara. Pavarësisht këtyre kërkesa i është refuzuar me vendimin me nr. të Ref.735/2020, të datës 15.09.2020, duke e arsyetuar se sipërfaqja e kërkuar është mbivendosur në sipërfaqen e një lënde tjetër me të cilën APK tashmë ka kontratë. Andaj padiësi thekson se pasi si palë e dëmtuar ka marrë pëlqimin nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, ka dal në terren së bashku me ekspertët, ka bërë kufizimin e të njëjtës, ekspertët nuk i kanë tërhequr vërejtjen se sipërfaqja është e nxënë dhe as Kryeshefi ekzekutiv i AKP-se nuk i ka furnizuar me Kontratën se kujt i është dhënë kjo sipërfaqe, kohën dhe personin se kujt, e ka lënë të dyshoj se përveç keqpërdorimeve zyrtare ka edhe shkelje procedurale të cilat Gjykata duhet ti evitoj për të mos ardhur deri tek ndonjë mosmarrëveshje ose konflikt me pasoja të paparashikuara sepse parashtruesi i kësaj padie ka planifikuar së bashku me familjen të investoj në ruajtjen dhe kultivimin e bagëtitve, shpeztarisë dhe bletarisë andaj i propozon gjykatës që pas shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave të bie Aktgjykim me të cilin anulohet vendimi i të paditurës MBPZHR, me numër të referencës KE-735/2020, dhe të obligohet MPPZHR-Agjencia Pyjore e Kosovës që padiësit t'ia jap në shfrytëzim paluajtshmerinë e kërkuar sipas dokumentacionit të plotësuar, nëse i plotëson kushtet ligjore.

Ndërsa në seancën e shqyrtimit gjyqësor e autorizuar e padiësit ka qëndruar në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke shtuar se në tërësi e kundërshton përgjigjen në padi dhe i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj kërkesëpadinë si të bazuar dhe të anulohet vendimi kontestues i të paditurës si i pa bazuar në ligj.

E Paditura, me përgjigje në padi, të parashtruar në gjykatë me datën 18.11.2022, e kundërshton në tërësi kërkesëpadinë e padiësit si të pa bazuar duke theksuar se padiësi ka parashtruar kërkesë

me nr.309 të datës 28.11.2020 për marrje me qira të tokës pyjore në ngastrën kadastrale me nr.04944-0 në Zhur Komuna e Prizrenit. Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për ndërrimin e destinimit të përkohshëm dhe dhënien e tokave pyjore me qira ka dalë në terren dhe ka verifikuar me anë të GPS sipërfaqen e kërkuar për tu marrë me qira, pas marrjes së të dhënave të nevojshme dhe pas vendosjes së koordinatave në sistem del se kjo kërkesë (një pjese e saj) bie mbi koordinatat e një kërkesë tjetër e cila është dhënë me qira. Kryeshefi ekzekutiv pas rekomandimit të komisionit me Vendimin me ref.KE-735/20 të datës 15.09.2020 bënë refuzimin e kërkesës pasi që nuk mund të aprovohen dy kërkesa për të njëjtin vend. Me tej, thekson, pretendimet e paditësit se ka marrë një informatë nga Drejtoria përkatëse e Komunës së Prizrenit si dhe ekspertet sipas paditësit që e kanë bërë ndarjen e parcelës, të njëjtit nuk janë zyrtar të Agresionit të Pyjeve por mund të jenë Gjeodet Privat ose të licencuar dhe ata nuk kanë pasur mundësi që ta dinë sa a i është dhënë dikujt tjetër kjo parcelë me qira. Në fund, thekson se, Pretendimi tjetër se Kryeshefi nuk i ka dhënë paditësit emrin apo kontratën e personit në ngastrën lëndore, thekson se paditësi asnjëherë nuk e ka kërkuar atë kurse si provë do ti paraqesin Gjykatës edhe dëshminë e aplikacionit si dhe kopjen e kontratës. Andaj e paditura MBPZHR-Agjencia Pyjore e Kosovës, bazuar në provat, faktet dhe rrethanat me rëndësi në këtë çështje juridike-administrative, i propozon Gjykatës që pas shqyrtimit të të gjitha provave, fakteve dhe rrethanave relevante, të bie aktgjykim me të cilin Refuzohet në tërësi padia dhe kërkesëpadia e paditësit të mbetet në fuqi vendimi me nr Ref: KE-735/20 i datës 15.09.2020.

Ndërsa i autorizuari i të paditurës edhe në shqyrtim gjyqësor ka mbetur pranë përgjigjes në padi duke e kundërshtuar në tërësi padinë e paditësit si të pa bazuar në ligj, sepse me rastin e refuzimit të kërkesës për marrjen në shfrytëzim të përkohshëm të tokës pyjore me qira janë respektuar të gjitha kriteret e parapara konform legjislacionit në fuqi dhe se kërkesa e palës paditëse ka ardhur një vit më vonë se ajo që i është aprovuar palës paraprake andaj nuk ka qenë e mundur që në të njëjtin vend të aprovohet edhe kërkesa e palës e cila ka ardhur më vonë, duke pasur parasysh edhe parimin juridik i pari nga koha i pari edhe nga e drejta.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 23.12.2022, ka administruar provat relevante si në vijim: vendimi i datës 04.09.2020 me nr. të ref. 15.09.2020, kërkesa për shfrytëzim të përkohshëm të tokës pyjore me qira e datës 28.01.2020, kërkesa për autorizim e dt.19.12.2019 me nr. të prot.561, autorizimi i dt.19.12.2019 me nr.ref.KE-APK-651/19, certifikata me nr.71813026-04944-0, kopja e planit të dt.19.12.19, shkresa-informimi i dt.26.12.2019 me nr.04-353-01-

172839, kopja e planit me nr.4944-0 e dt.08.01.2020, kopja e letërnjoftimit për H.A. 05.06.2010, kërkesa e dt.24.01.2020, shkresa-informimi i dt.26.12.2019, nr.prot. 04-353-839, kopja e planit të dt.19.12.19 me nr.parc. 71813026-04944-0, licenca e dt.08.12.16, kontrata për qiranë e dt.22.07.20 me nr. te referencës KE594/20 me nr. prot. 3001 i dt.27.07.20, kërkesa për shfrytëzim të përkohshëm të tokës pyjore me qira te dt.20.12.19 e prot. me dt.20.12.19 me nr.prot.5668, raporti i komisionit me nr. të lëndës NP309 e dt.28.01.20 me nr.prot.3576 e dt.01.09.2020.

Gjykata vlerësoj ligjshmërinë e aktvendimit të goditur me padi, në përputhje me nenin 43 dhe 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, thënieve të padisë, përgjigjes së dhënë nga e paditura, dhe gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit me nr. te ref.:KE-735/20 të paditurës lidhur me refuzimin e kërkesës së palës paditëse dhe gjeti se, ky vendim është i ligjshëm dhe në përputhje me Udhëzimin administrativ NR.41/2006 dhe Udhëzimi Administrativ për Ndryshimin dhe plotësimin e UA NR.41/2006 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore i cili i ka dhënë kompetencë këtij komisioni të vendos në bazë të nenit 13.5. Agjencia e Pyjeve e Kosovës, formon komision të veçantë për shqyrtimin e kërkesave dhe i rekomandon Kryeshefit Ekzekutiv të APK –së aprovimin apo refuzimin e kërkesës.

Gjykata vlerësoj se refuzimi i kërkesës ishte i bazuar dhe janë zbatuar kriteret ligjore sepse Agjencia Pyjore e Kosovës, nuk mund të lejoj të aprovohen dy kërkesa për të njëjtin vend/parcelë. E në rastin konkret ekziston një kërkesë e aplikantit F.H me nr. të aplikacionit 5668 të datës 20.12.2019, dhe Kontrata për qiranë e lidhur në bazë të pëlqimit nr.ref.KE-593/20 e datës 27.07.2020, të cilën Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave për ndërrimin e Destinimit të Përkohshëm dhe Dhënien e Tokave me Qira e kishte vërtetuar pas marrjes së kërkesës nga H.A me c ‘rast kishte ndalur në terren dhe kishte verifikuar me anë të GPS sipërfaqen e kërkuar për tu marrë me qira dhe pas marrjes së të dhënave të nevojshme dhe pas vendosjes së koordinatave në sistem kishte dal se kjo kërkesë (një pjesë e saj) bie mbi koordinatat e një kërkesë tjetër e cila është dhënë me qira andaj, Kryeshefi Ekzekutiv pas rekomandimit të komisionit me vendimin e lartë cekur kishte bërë refuzimin e kërkesës për këtë arsye.

Vendimin e tillë gjykata e konstaton si të ligjshëm dhe në përputhje me Ligjin për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore, Ligjit mbi Pyjet nr.2003/3, Ligjit për Tokën Bujqësore 02/L-26 dhe Udhëzimet administrative: UA nr.10/2010 Për Plotësim Ndryshimin e

UA nr.41/2006 si dhe UA, nr.01/2011, UA nr.10/2010 për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore, UA 01/2020, sepse në rast të kundërt Agjencia Pyjore e Kosovës, do të bënte shkelje duke aprovuar dy lëndë/kërkesa në një parcelë, ngase u vërtetua se me datë 20.12.2019 me numër protokolli 5668 kishte arrit kërkesa e aplikantit F.H, ndërsa me datë 28.11.2020, me nr. protokolli 309, kishte arritur kërkesa e paditësit, kështu që nuk ka mundur të aprovohet kërkesa e paditësit e cila kishte ardhur afërsisht një vit më vonë.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e paditësit të dhëna në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor por të njëjtat pretendime i vlerësoi si të pa bazuara, pasi që paditësi nuk ka argumentuar në mënyrë që gjykata të ketë një vendim ndryshe nga ai në dispozitivin e vendimit. Në këtë kuptim gjykata vlerëson se vendimi kontestues i të paditurës , është i drejtë dhe bazuar në ligj dhe se organi i paditur, drejtë ka zbatuar dispozitat ligjore, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material. Mbi këto arsye kërkesëpadinë e paditësit nuk e aprovoi, sepse vlerëson se nuk është cenuar ligji në dëm të tij.

Andaj, duke u bazuar në të dhënat e lartë cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE  
A.nr. 1732/20, data 23.12.2022

Bashkëpunëtore profesionale  
Edita Kolgeci

Gj y q t a r e  
Luljeta Maxhuni

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.